<p>Përmbajtja:</p>	<p>Ne jetojmë në një botë të përbërë nga kultura, gjuhë, raca dhe sfode historike të ndryshme. Kjo shumëllojshmëri e bën jetën tonë më interesante, por vetëm nëse jemi në harmoni me njeri tjetrin. Gjithashtu u bë e qartë se ambjenti ku mëson fëmija shtrihet përtej ambjentit të shtëpisë apo qendrave të fëmijërisë së hershme jashtë shtëpisë.</p> <p>Kuadri konceptual i fëmijës në kontekstin e familjes së tyre dhe të komunitetit u hartua dhe u ndikua duke u bazuar në Teorinë e Sistemeve Ekologjike Bronfenbrenner (Bronfenbrenner 1979). Teoria e Sistemeve Ekologjike shpjegon se si mjedisi social i fëmijëve ndikon në rritjen dhe zhvillimin e tyre.</p> <p>Sipas Bronfenbrenner, mjediset që ndikojnë në zhvillimin e fëmijëve variojnë nga sistemet mikro në sistemet makro. Sistemet mikro i referohen marrdhënies midis fëmijës dhe mjedisit të menjëhershëm siç janë prindërit, shtëpia dhe familja. Ndërkohë që fëmija rritet, sistemet makro bëhen më komplekse, duke përfshirë më shumë njerëzës siç janë qendrat e fëmijërisë së hershme. Sistemet makro janë strukturat më të mëdha sociale të cilat janë të largëta për fëmijën, por që ende kanë ndikim të madh mbi fëmijën. Sistemet makro përfshijnë kontekste më të gjera të modeleve institucionale të kulturës të tilla si politikat qeverisëse, ekonomike, të medias, luftës dhe konfliktit.</p> <p>Duke menduar ekologjikisht rreth ndërtimit të paqes, ne pranojmë pohimin e Galtung se “Paqja është më shumë se mungesa e Luftës” (Galtung 1996). Prandaj ndërtimi i paqes bën fjalë jo vetëm për adresimin e dhunës fizike dhe ndikimin e saj në jetën e fëmijëve të vegjël, por bën fjalë edhe për adresimin e dhunës strukturore dhe kulturore. Gjithashtu si një ndikimin të tmerrshëm të dhunës fizike, ne duhet të pranojmë edhe pabarazitë në aksesin për kujdes shëndetësor, dhunën kulturore të tillë si pabarazitë gjinore dhe ndikimin e tyre tek fëmijët e vegjël. Nëpërmjet këtij këndvështrimi ekologjik shumë-dimensional, ne pranojmë se nëse duam që ndërtimi i paqes të jetë i qëndrueshëm, duhet të përfshijë dimensionet ligjore, kulturore dhe socio-ekonomike të jetës së fëmijëve të vegjël.</p> <p>Fëmija - Ndërsa natyra dhe shkalla e konfliktit është e ndryshme në çdo situatë, rezultati është që fëmijët e vuajnë këtë gjë si një fatkeqësi direkte, fizike apo emocionale. Prandaj fëmija është në qendër të punës dhe të menduarit tonë, ndaj dhe të gjitha veprimet e ndërmarra duhet të marrin në konsideratë mjediset e ndryshme që kanë ndikim tek fëmija.</p> <p>Familja - Situatat konfliktuale mund të sjellin stres dhe tension në familje gjë e cila ndikon në aftësinë e tyre për t’u kujdesur për fëmijët e tyre në mënyrë efektive. Trauma e përjetuar në familje mund të kuptohet dhe brëndësohet nga fëmijët. Gjithashtu, urrejtja dhe paragjykimi mund të kalojë nga një brez tek tjetri. Për këtë arsye ne duhet të mbështesim familjet në situata konfliktuale. Programet e Fëmijërisë së Hershme që kanë si komponent të fortë edukimin e prindërve, mund të kenë një ndikim veçanërisht të fuqishëm në kapitalin social, duke bërë që prindërit të ndërtojnë besimin mes grupeve të ndara “(ACEV 2008).</p>
---------------------------	---

Përmbajtja:

Qendrat e fëmijërisë së hershme - Sipas Connolly dhe Hayden (2007) programet e Zhvillimit të Fëmijërisë së Hershme (ECD), kanë aftësinë që të inkurajojnë komunitetet në konflikt që të zhvillojnë vizione alternative për të ardhmen bazuar në nevojat e fëmijëve. Si pasojë e konfliktit, ri-ndërtimi i shoqërisë është një sfidë pasi ata karakterizohen zakonisht nga mosbesimi, tensioni dhe urrejtja. Shumë prej marrëdhënieve ndërpersonale i kanë rrënjët e tyre në fëmijërinë e hershme, për këtë arsye ndërhyrjet në vitet e fëmijërisë së hershme mund të kontribuojë në ndryshimin e sjelljes. Të gjitha programet e Fëmijërisë së Hershme, duhet të bazohen në pedagogjinë me fëmijën në qendër dhe të përqëndrohet në ndërtimin e ndjeshmërisë, vetë-vlerësimin dhe respektin për të ndryshmen, diversitetin. “Arsimi në përgjithësi veçanërisht kopshtet apo qendrat e fëmijërisë së hershme janë një vlerë e madhe psikologjike dhe e menjëhershme gjatë periudhës së luftës duke ofruar një hapësirë të sigurtë për fëmijët si dhe ofrojnë shpresë në situatat kaotike ose me fjalë të tjera situata që në dukje janë të pashpresa” (UNESCO 2002; Nixon 1996).

Komunitetet e mëdha - Konflikti mund të sjellë si rezultat jo vetëm shkatërrimin e familjes por edhe shpërbërjen e komuniteteve. Ai mund të ndikojë në shërbimet që ofrojnë spitalet, në aksesin e rrugëve, higjenë dhe furnizimin me ujë. Kjo mund të sjellë jo vetëm vuajtje dhe zhvendosje, por edhe krijimin e ndarjeve të reja të thella në komunitet (Connolly dhe Hayden 2007). “Kur programet e Fëmijërisë së Hershme janë të hartuara si ndërhyrje për zhvillimin shoqëror duke tejkaluar nivelet mikro dhe makro në shoqëritë e pritura drejt konfliktit, ata mund të ndërhyjnë në ndarjet e komunitetit dhe kanë një ndikim pozitiv në kapitalin social dhe dinamikat pro paqes’ (ACEV 08).

Kultura, Ekonomia, Qeverisja, Kërkimet, Media - Ky është grupi më i madh dhe më i largët i strukturave shoqërore që kanë një ndikim të madh mbi fëmijën. Këtu përfshihen: liritë e lejuara nga qeveria e vëndit; vlerat kulturore; ekonomia; ndikimi i medias dhe programet e bazuara në fakte. Këto ndikime mund të ndikojnë një fëmijë pozitivisht ose negativisht. Nga një pikëpamje ekologjike është thelbësore që praktika dhe advokacia të arrijnë këtë nivel. Për të ndërtuar një paqe të qëndrueshme, duhet të adresohen të dyja shkaqet e dhunës, shkaqet e drejtpërdrejta dhe ato jo të drejtpërdrejta. Në mënyrë që të drejtat e fëmijëve të vegjël të mbrohen tani dhe në të ardhmen duhet të vendosen ura lidhëse ndërmjet praktikës dhe politikave, medias dhe niveleve të qeverisjes.

Roli i profesionistëve/mësuesve/të rriturve është një rol kyç në mbështetjen që u jepet fëmijëve për të fituar vlera, qëndrime dhe aftësi për të trajtuar diversitetin/ndryshueshmërinë pozitivisht dhe për t’i bërë aktorë socialë në ndërtimin e paqes.

Organizimi i aktiviteteve për ndërtimin e paqes në punën tuaj me fëmijët, ju mund të siguroni që interesat më të mira të fëmijëve dhe familjeve janë parësore në punën tuaj. Vlerat e bazuara tek të drejtat themelore të fëmijëve të tilla si, e drejta për t’u dëgjuar, respektuar, e drejta për barazi, pjesmarrje, mbrojtje dhe lojë, mund të vendosen/nguliten në praktika të përshtatshme sipas moshës. Ky është ndërtimi i paqes në nivel individual (ndërtimi i paqes nga brenda dhe jashtë).

Metodat e realizimit të programit	<p>Metodologjia e trajnimit do të përmbajë teknika të shumta që synojnë gjithpërfshirje aktive të pjesëmarrësve dhe ndërveprim të vazhdueshëm mes tyre përgjatë gjithë zhvillimit të modulit. Në vijim të trajnimit do të ketë kombinim të aspekteve teorike rreth koncepteve kyçe me aktivitete dhe lojëra konkrete e praktike të cilat do të zhvillohen bashkë me pjesëmarrësit për të rritur kapacitetet dhe aftësitë e tyre në zbatimin e metodave të PRECEDE me grupe të fëmijëve. Gjithashtu moduli do të ofrojë shfaqje të videove të ndryshme nga aktivitetet praktike dhe prezantime në PowerPoint, për ta bërë modulin sa më të vlefshëm për pjesëmarrësit. Punët në grupe dhe diskutimet e hapura me pjesëmarrësve janë gjithashtu një aspekt tjetër i rëndësishëm i këtij moduli, që do të ofrojë qasje për të gjithë pjesëmarrësit dhe ndërveprim mes tyre në zhvillimin e mëtejshëm të të kuptuarit të përbashkët të qëllimeve të PRECEDE dhe do të ndihmojë në eliminimin e barrierave dhe të vështirësive të aspekteve teknike të aplikimit të këtij moduli me fëmijët e grupmoshave parashkollore.</p>
Certifikimi	Të gjithë pjesëmarrësit do të marrin certifikatë në fund të programit trajnues
Trajner sa trajner	3 trajner. - Laura Ceku Gjikoka - Mevlude Murtezi - Klevis Vaqari
Data e aplikimi	05.01.2019

Titulli i Programit 84	Orientimi në karrierë – Njohuri të përgjithshme
Titulli i organizatës	LuxDev Project KSV/020 Smart Bits
Tipi i programit:	Program trajnues plotësues
Ofertuesi i programit:	LuxDev Project KSV/020 Smart Bits
Adresa:	Rr. Agim Ramadani p.n., 10000 Prishtinë Rr. Xheladin Hana p.n., 10000 Prishtinë
E-mail:	Daniele Cristian Passalacqua: daniele.passalacqua@luxdev.lu Bekim Kasumi: bekim.kasumi@smart-bits.ch
Telefoni:	Daniele Cristian Passalacqua: +38345300916 Bekim Kasumi: +38344168688
Numrat dhe data e akreditimit:	Nr.84/2018 Datë:12.11.2018 Programi aprovohet për një vit nga ana e MASHT-it
Kohëzgjatja e programit(orë)	24 orë
Përfituesit:	Me Kurrikulë të re Orientimi në Karrierë është pjesë e fushës Jeta dhe Puna, prandaj ky trajnim u dedikohet të gjithë mësimitdhënësve të fushës Jeta dhe Puna të klasëve VI-XII.
Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:	16 kandidatë për sesion të trajnimit
Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:	Aftësimi i pjesëmarrësve me njohuritë bazë të procesit të Orientimit në Karrierë, me instrumentet kyçe, me veprat më të përhapura dhe më të sofistikuara që mund të përdoren për situata dhe audiencat të ndryshme.
Përmbajtja:	Ky është program modular dhe certifikimi bëhet në baza modulare për secilin nga 8 modulet në vijim: <ul style="list-style-type: none"> · T'i njeh nocionet kyçe të Orientimit në karrierë · Njohja me planprogramin mësimor për orientimin dhe edukimin në karrierë · Kompetencën orientuese gjatë zgjedhjes së shkollës dhe profesionit · Profesionet, klasifikimi i tyre dhe sektorët që u korrespondojnë · Zgjedhja e shkollës dhe nivelet e ndryshme të karrierës profesionale · Klasifikimi i profesioneve sipas ESCO, ISCED dhe KK · Përgaditje për organizimin e takimeve reale me ekspertë në shkollë dhe jasht shkollë · Tranzicioni nga shkollat mesme e ultë në shkollat mesme të lartë · Vizitat në shkollat të mesme të larta · Klasifikimi i nxënësve nëpër grupe të interesit për vizita në SHML · Vizitat në ndërmarrje dhe institucione, panairë, etj · Informacionet e përgjithshme mbi sistemin e shkollimit · Rëndësia e praktikës për karrierë

<p>Metodat e realizimit të programit</p>	<p>Për të siguruar realizim të suksesshëm të objektivave të programit, masat në vijim do të aplikohen:</p> <ul style="list-style-type: none"> · Objektivat e mësimit / trajnimit, · Mësimi i orientuar në shkathtësi dhe kompetenca, · Njohjen paraprake të nevojave të pjesëmarrësve të trajnimit dhe ofrimin e trajnimit konform atyre nevojave, · Disponueshmëria e pjesëmarrësve, · Vendet e trajnimit, · Materialet e trajnimit, · Aftësitë e trajnerit.
<p>Certifikimi :</p>	<p>Certifikatë modulare pas përfundimit me sukses të detyrave që ndërlidhen me modulet përkatëse</p>
<p>Trajner sa trajner</p>	<p>4 trajnerë të programit dhe trajnimi i 10 master trajnerëve</p>
<p>Data e aplikimi</p>	<p>26.10.2018</p>

Titulli i programit 85	RINDERTIMI AKADEMIK NË EVROPEN JUGLINDORE
Titulli i organizatës	INSTITUTI I EVROPËS JUGLINDORE PËR AVANCIME NË SHËNDETËSI DHE INFERMJERII
Tipi i programit:	
Ofertuesi i programit:	
Adresa:	Rr. "Bulevardi i Dëshmoreve ",Fakulteti I Mjekësisë, ndërtesa B kati I III-të,10000 Prishtinë
E-mail:	kontakt@nsnh-see.net , pb@nsnh-see.net , nbr@nsnh-see.net
Telefoni:	045/820/820 0038138552447
Numrat dhe data e akreditimit:	43/11 06.11.2011
Kohëzgjatja e programit(orë)	1 VIT (12 Muaj)
Përfituesit:	Mësimdhënësit e Universiteteve, mentor dhe klinik te QKU-ve ,Prishtinë, Tiranë, Tetovë, Vlorë
Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:	
Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:	AkademicReconstructioninsouthEastEurope,intercollegiatecooperation in nursing and health management.Financed by DAAD. Strategic framework for the establishment of a Masters program and a network working for infirmery in Southeast Europe.Coordinator of the project.Financed by DAAD.
Përmbajtja:	Java e I ORË Seminar ikë 06.06.-10 .06.2005 në Prishtinë Kosovë Tema: Preventiva dhe promovimi I shëndetit dhe roli politiko shoqëror I infermierisë në vendet e SOE-se · Menaxhimi I projektit 2.Java e II-të seminar ike 03.10-07.10.2005 Vlorë-Shqipëri Tema Perspektiva bash kohore mbi edukimin shëndetësor. Konceptet e reja të nxënies dhe zbatimi I tyre në edukimin e vazhduar.
Metodat e realizimit të programit	
Certifikimi	
Data	12.10.2011

Titulli i Programit 86	Roli i Busulla.COM në përbushjen e objektivave nga fusha Jeta & Puna
Titulli i organizatës	LuxDev Project KSV/020 Smart Bits
Tipi i programit:	Program trajnues plotsues
Ofertuesi i programit:	LuxDev Project KSV/020 Smart Bits
Adresa:	Rr. Agim Ramadani p.n., 10000 Prishtinë Rr. Xheladin Hana p.n., 10000 Prishtinë
E-mail:	Daniele Cristian Passalacqua: daniele.passalacqua@luxdev.lu Bekim Kasumi: bekim.kasumi@smart-bits.ch
Telefoni:	Daniele Cristian Passalacqua: +38345300916 Bekim Kasumi: +38344168688
Numrat dhe data e akreditimit:	Nr.86/2018 Datë:12.11.2018 Programi aprovohet për një vit nga ana e MASHT-it
Kohëzgjatja e programit(orë)	8 orë
Përfituesit:	Me Kurrikulen e re Orientimi në Karrierë është pjesë e fushës Jeta dhe Puna, prandaj ky trajnim u dedikohet të gjithë mësimeve të fushës Jeta dhe Puna të klasave VI-XII.
Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:	16 kandidatë për sesion të trajnimit
Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:	Njohja me obligimet që rrjedhin nga Fusha Jeta dhe Puna, KKK dhe Kurrikulen Bërthamë dhe mundësitë e përbushjes së këtyre obligimeve përmes përdorimit dhe inkorporimit të platformës për orientim në karrierë dhe këshillim në procesin mësimor.
Përmbajtja:	Përmbajtja e këtij moduli është si në vijim: <ul style="list-style-type: none"> · Njohja e çfarë parashihet në KKK për orientimin profesional dhe edukimin në karrierë? · Njohja me rezultatet e parapara nëpër shkallë të ndryshme të KKK për orientim profesional dhe edukim në karrierë · Njohja me mundësitë e inkorporimit të veglave të Busulla.COM në realizimin e këtyre objektivave · Njohja e mundësive të përdorimit të veglave digjitale për përfundim të orientimit në karrierë · Njohja e mundësive të përdorimit të veglave digjitale për përgatitje për jetë dhe punë.
Metodat e realizimit të programit	Për të siguruar realizim të suksesshëm të objektivave të programit, masat në vijim do të aplikohen: <ul style="list-style-type: none"> · Objektivat e mësimi / trajnimit, · Mësimi i orientuar në shkathësi dhe kompetenca, · Njohjen paraprake të nevojave të pjesëmarrësve të trajnimit dhe ofrimin e trajnimit konform atyre nevojave, · Disponueshmëria e pjesëmarrësve, · Vendet e trajnimit, · Materialet e trajnimit, · Aftësitë e trajnerit.
Certifikimi :	Certifikatë modulare pas përfundimit me sukses të detyrave që ndërliken me modulet përkatëse
Trajner sa trajner	4 trajnerë të programit dhe trajnimi i 10 master trajnerëve
Data e aplikimi	26.10.2018

Titulli i Programit 87	Programi për mësime të rinia
Titulli i organizatës	Rrjeti i edukatorevë bashkëmoshatarë - PEN
Tipi i programit:	
Ofertuesi i programit:	Rrjeti i edukatorevë bashkëmoshatarë – PEN
Adresa:	Rr. Behije Dashi, 5A, Prishtinë
E-mail:	info@ngo-pen.com
Telefoni:	+383 38 223 942 /+383 49 727 072
Numrat dhe data e akreditimit:	012/2018 data e akreditimit: 23.01.2018 Programi aprovohet për dy vite nga ana e MASHT-it
Kohëzgjatja e programit(orë)	Shtator 2018- Tetor 2020, programi është parapare të mbahet një ditore (8) orë dhe tre ditore (24) orë. Për mësime të rinia: Për trajnimin dhe përgatitjen e mësime të rinia do të duhen se paku 2 vikende, me gjithsej 24 orë trajnimi, të punëtorëve bazike dhe atyre të avancuara. Do të ketë edhe tryeza të rumbullakëta dhe takime tjera të cilat do të planifikohen për ndërtimin e kapaciteteve të mësime të rinia. Për nxënësit: 3 vite gjithsej Doracak ka 40 workshope/Punëtori, ku parashihen 10 të realizohen gjatë klasës së 10, 15 të tjerë do mbeten për klasën e 11 dhe 15 do të barten për klasën e 12. Kohëzgjatja e një workshopi parashihet të jetë nga 40-60 minuta.
Përfituesit:	Profesorët e shkollave të mesme, Nxënësit e shkollave të mesme, Studentët e Universitetin e Prishtinës – Fakultetin e Edukimit dhe Filozofik. Ky program i dedikohet mësime të rinia të shkollave të mesme të larta. Gjithashtu nga ky program do të mund të përfitojnë edhe mësime të rinia e shkencave sociale, Pedagogët, Psikologët dhe Biologët dhe si pjesë e fundit vet nxënësit. Ky program mund të shërbejë për përdorim edhe për edukatorët, punëtorët me të rinjtë dhe profesionistët e tjerë që punojnë me djemtë e rinjapo vajzat e reja, si një kontribut i rëndësishëm për ata që punojnë për të mbështetur zhvillimin e shëndoshë të të rinjve. Duke përdorur perspektivën gjinore dhe duke u fokusuar në maskulinitet, ky doracak përpiktë analizojë disa prej pengesave më cilat të rinjtë ballafaqohen në moshën e adoleshencës. Doracak mëton të krijojë aftësitë që u nevojiten të rinjve për të zhvilluar marrëdhënie të shëndosha dhe të mbështetura në barazinë gjinore, për të kuptuar zhvillimin e tyre fizik, seksual dhe emocional dhe për të adresuar të gjitha format e dhunës në jetën e tyre të përditshme
Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:	150 pjesëmarrës/e, total numri i paraparë është për të gjithë periudhën 2018-2020 rreth 50 mësime të rinia direkt dhe 150 indirekt. Numri për një trajnim është paraparë prej 13-15 pjesëmarrës/e.

Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:	<p>Qëllimi i përgjithshëm i programit është parandalimi i dhunës në shkollat e mesme të Kosovës, mënyra e shëndetshme e jetesës, parandalimi i abuzimit me droga dhe alkool dhe barazia gjinore.</p> <p>Mepërvetësimine këtijProgrami pjesëmarrësit duhet të jenë ne gjendje të:</p> <ul style="list-style-type: none"> · Të zhvillohen, teknika dhe strategji të reja, moderne të mësimdhënies dhe të mësim nxënës, të cilat lehtësojnë përvetësimin e njohurive dhe zhvillimin e kompetencave të nxënësve të parapara me Kornizën e Kurrikulës. · Të përdorin aktivitete të shumëllojshme e të efektshme, të cilat ndihmojnë dhe ndikojnë tek nxënësi në procesin e përmirësimit të barazisë gjinore, uljen e dhunës, dëmet nga abuzimet me droga dhe infeksionet seksualisht të transmetuara në kuadër të shkollave të mesme të Kosovës. · Të krijojnë në klasë dhe jashtë saj një kulturë të bazuar në të drejtat e njeriut, pa dhunë dhe zhvillimin e shëndetshëm mes rinjve dhe të rejave dhe të komunitetit në përgjithësi. · Të rinjtë e moshës 14-18 të mbajnë qëndrime dhe të demonstrojnë sjellje të cilat mbështesin më shumë norma gjinore të barabarta, jetesës së shëndetshme dhe të dekurajojnë sjelljen e dhunshme kundër komunitetit, vajzave dhe bashkëmoshatareve. · Të promovojnë aftësitë pozitive jetësore dhe normat e barazisë gjinore për një kalim të shëndoshë të nxënësve nga adoleshenca në moshën madhore.
Metodat e realizimit të programit:	<p>Manuali Y përmban 4 module tematike në të cilat përfshihen gjithsej 40 punëtori që kanë të bëjnë me edukimin e të rinjve. Gjithashtu trajnimit për profesorë, nxënës të shkollave të mesme dhe studentë do të zgjasë 3 ditë mirëpo do të ketë mundësi zgjatje për 1 ose më shumë ditë varësisht nga nevoja, trajnimi do të zhvillohet me agjendë fleksibilitet dhe do të ketë lojëra me role në mënyrë që pjesëmarrësit të mund ti përvetësojnë njohurit që i marrin në mënyrë më të duhur.</p> <p>Metoda të ndryshme edukative si: seminare, trajnime, kurse online, takime kongrese ekspertesh, për ndërtimin e kapaciteteve në fusha: Pse të punojmë më burrat e rinj, zhvillimi pozitiv i të rinjve, praktikat sionisteve gjinore dhe parandalimin e dhunës.</p>
Certifikimi:	Përmes akreditimit pjesëmarrësit certifikohen një ditë 8 (orë) si dhe trajnim residencial 3 ditë (24 orë)
Trajner sa trajner:	5 trajner
Data e aplikimi:	06.02.2019

Titulli i programit 88	“SHKOLLAT GJITHËPËRFSHIRËSE QË MBËSHTET ARSIMIN E KOMUNITETEVE ROM, ASHKALI DHE EGJIPTIAN DHE FËMIJËT E KTHYER”
Titulli i organizatës	Këshilli i Evropës
Tipi i programit:	Plotësue
Ofertuesi i programit:	
Adresa:	“Bedri Pejani”, 10000, Prishtë
E-mail:	Coe.pristina@coe.int / giovanni.mozzarelli@coe.int
Telefoni:	
Numrat dhe data e akreditimit:	132/2015 21.12.2015 riakreditohet për 2 vite
Kohëzgjatja e programit (orë)	<p>Programi i trajnimit të mësimit ndërohet mbi tre pjesë bazë të trajnimit, të shpërndara në:</p> <p>Ditët e trajnimit me pjesëmarrje :Realizimi i trajnimit përfshinë 6 ditë e gjysmë trajnim me pjesëmarrje (prezencë në seancat e trajnimit) të ndara në tre pjesë, sipas shpërndarjes:</p> <p>Pjesa I: 2,5 DITË= 20 orë trajnim</p> <p>Pjesa II: 2 ditë trajnim= 16 ORË TRAJNIM</p> <p>Pjesa III: 2 DITË TRAJNIM-16 orë trajnim</p> <p>Gjithsej=52 orë trajnim me pjesëmarrje</p> <p>Detyrat praktike: pas secilës pjesë të trajnimit ,pjesëmarrësit i jepen 10 orë për të përfunduar një detyrë apo projekt të caktuar .Pra ,secili pjesëmarrës ,gjatë programit të trajnimit realizon të paktën 30 orë punë praktike</p> <p>Mentorimi i pjesëmarrësve :pas secilit seminar pjesëmarrësit monitorohen në vendin e punës. Janë planifikuar nga 3 orë mentoruese për secilën pjesëmarrës pas seminarit. Gjithsej janë 9 orë mentoruese për secilin pjesëmarrës.</p> <p>Vlerësimi i programit përmes:</p> <ul style="list-style-type: none"> -Monitorimi dhe vlerësimi gjatë realizimit të seancave të trajnimit -Monitorimet dhe vlerësimi të drejtpërdrejtë në vendin e punës -Veprimtaria praktike -Ushtrime përmbyllëse -Pyetje reflektuese <p>Fletëve vlerësuese për programin</p> <p>Gjithsej janë 91 orë trajnimi të bartura në certifikim</p>

Përfituesit:	Trajnimi është përgatitur për mësime të nivelit të gjatë të arsimit para universitar. Ekipe të mësimeve nga e njëjta shkollë priten që të marrin pjesë dhe të bashkëpunojnë për realizimin e detyrave të marra pas çdo pjese të trajnimit. Pjesëmarrja e tyre duhet të jetë në pajtimin dhe me mbështetjen nga drejtori i shkollës dhe këshilli i shkollës (Këshilli Drejtues i Shkollës). Sugjerohet që çdo ekip të përbëhet nga 3 mësime të shkollës fillore dhe 3 mësime të shkollës së mesme të ultë, si dhe të përfshij si mësime me përvojë të ndryshme (mësime me përvojë dhe mësime me më pak përvojë).
Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:	
Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:	<p>Trajnimi synon zhvillimin e kapaciteteve të shkollave të Kosovës për të ofruar mjedis gjithëpërfshirës dhe ndërkulturore që lehtëson dhe mbështetë integrimin efektiv të fëmijëve romë, ashkali, egjiptianë dhe të kthyer (riatdhesuar), duku rritur mundësitë e suksesit në shkollë të gjithë fëmijëve.</p> <p>Objektivat kryesorë të kurrikulës së trajnimit janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Rritja e ndërgjegjësimit të mësimeve për rolin dhe përgjegjësitë e tyre në zhvillimin e nxënësve të tyre, si edhe për rëndësinë e adresimit të çështjeve si diskriminimi, racizmi, përfshirja sociale dhe të kuptuarit ndërkulturore, • Ofrimi i metodologjive dhe burimeve me një sfond teorik të qëndrueshëm duke u mbështetur në përvojën e këshillit të Evropës në këtë fushë, të cilat mund të kenë përdorim praktik në aktivitete që mund të organizohen në nivel shkollor, bazuar në një qasje që përfshinë gjithë shkollën, • Krijimi i mundësive për përfshirje aktive të mësimeve në një reflektim kritik në lidhje me praktikën e tyre, në shkëmbimin e përvojave me kolegët dhe në gjenerimin e procesit të qëndrueshëm, demokratik dhe pjesëmarrës të zhvillimit të shkollës së tyre.

<p>Përmbajtja:</p>	<p>Përmbajtja e trajnimit për Pjesën I</p> <ul style="list-style-type: none"> • Hapja, prezantimet ,objektivat ,rregullat, pritesmeritë ,programi • Pabarazia sociale, rrënjët e saj dhe pasojat tek fëmijët, • Roli I shkollave dhe mësimeve në riprodhimin e pabarazisë • Racizmi: Diskriminimi direkt ,indirekt dhe diskriminimistrukturor, • Qasja e gjithë shkollës për një shkollë gjithëpërfshirëse dhe ndërkulturore, • Krijimi I një klase gjithëpërfshirëse dhe ndërkulturore • Shembuj të metodave ,aktiviteteve dhe masave • Nxënësit e bazuar në projekte • Planifikimi I zhvillimit të shkollës. Puna ekipore, • Detyrat e shtëpisë: Detyra deri në pjesën e dytë të trajnimit. Vlerësimi, <p>Përmbajtjet e trajnimit për pjesën II</p> <ul style="list-style-type: none"> • Hapja e pjesës së dytë të trajnimit dhe rishikimi I Planeve të zhvillimit të shkollës. • Rishikimi I rasteve studimore për fëmijët e sapo ardhur në klasë, • Nxitja e gjithë përfshirjes së fëmijëve të riatdhesuar romë, ashkalinj dhe egjiptianë, • Ushtrime për të nxënësit bashkëpunues gjatë punës me fëmijët e kthyer • Ndërgjegjësimi kulturor ,ndërgjegjësimi gjuhësor dhe edukimi ndërkulturor, • Mentorimi dhe ndërmjetësimi nga bashkëmoshatarët (në mes të nxënësve), • Bashkëpunimi me prindërit. Roli I ndërmjetësuesve arsimor në shkollë • Bashkëpunimi që një vlerësim me pjesëmarrje participuese dhe mbështetëse zhvillimin e shkollës, • Mbyllja e trajnimit
<p>Metodat e realizimit të programit</p>	
<p>Certifikimi</p>	
<p>Trajneer</p>	<p>8</p>
<p>Data</p>	<p>02.11.2015</p>
<p>Titulli i organizatës</p>	<p>Këshilli i Evropës</p>

Titulli i Programit 89	„Shkollagjithpërfshirëse që mbështet të arsimimin e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian dhe fëmijët e kthyer”
Titulli i organizatës	Instituti Pedagogjik I Kosovës
Tipi i programit:	
Ofertuesi i programit:	Instituti Pedagogjik I Kosovës
Adresa:	Kompleksi Rilindja, Kontinieri nr. 2, 10000, Prishtinë
E-mail:	Nezir.Cocaj@rks-gov.net
Telefoni:	+383213835
Numrat dhe data e akreditimit:	Riakreditimi, Nr :015/2018 Datë: : 23.01.2018 Programi aprovohet për dy vite nga ana e MASHT-it
Kohëzgjatja e programit(orë)	<p>Programi i trajnimit të mësimit ndërohet mbi tre pjesë bazë të trajnimit, të shpërndara:</p> <p>Struktura e programit të trajnimit, referuar dy fazave të zhvillimit profesional:</p> <p>1. Mësimdhënës i karrierës- program i trajnimit synon arritjen e kompetencave të përshkruara në dokumentin <i>Korniza për zhvillimin profesional të mësimit në Kosovë</i>: - Zotërimi i përmbajtjeve mësimore,</p> <ul style="list-style-type: none"> - Zgjerimi i repertorit të shkathtësive pedagogjike, metodologjive dhe dhe teknikave mësimore, - Vlerësimin e nxënësve dhe shfrytëzimin e rezultateve të vlerësimit për t’ia përshtatur mësimit nxënësve, - Motivimin e nxënësve , punën ekipore me kolegët, aktivitetet profesionale , me prindër dhe komunitetin. <p>Në këtë fazë duhet të arrihet krijimi i besimit dhe shkathtësive</p> <p>Në funksion të arritjes së kompetencave përkatëse, programi ka këtë strukturë:</p> <p>Ditët e trajnimit me pjesëmarrje : Realizimi i trajnimit përfshin 6 ditë e gjysmë trajnim me pjesëmarrje (prezencë në seancat e trajnimit) të ndara në tre pjesë. Metodatat e punës janë të kombinuara: ligjërim, prezantim në PP, interaktivitet, punë individuale/çifte/grupore, debateve, luajtje e roleve, punë praktike, studim pavarur, etj. Përfundimi me sukses i një moduli konsiston me 81 orë trajnimi me pjesëmarrje në program, sipas shpërndarjes:</p> <p>42 orë trajnim me pjesëmarrje 30 orë punë praktike. 9 orë mentoruese për secilin pjesëmarrës.</p>

<p>Kohëzgjatja e programit(orë)</p>	<p><u>Gjithsej janë 81 orë trajnim të bartura në certifikim</u></p> <p>2. Për Mësimdhënës të avancuar – program i trajnimit synon arritjen e kompetencave të përshkruara në dokumentin <i>Korniza për zhvillimin profesional të mësimdhënësve në Kosovë</i>:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Zbatimi mjeshtëror i përmbajtjeve lëndore - Demonstrimin e eksperiencës në një spektër të gjërë të shkathtësive pëdagogjike, metodologjive dhe teknikave mësimore, - Vlerësimin e nxënësve dhe shfrytëzimin e rezultateve për t’ia përshtatur mësimdhënien nxënësve, - Demonstrimin e motivimit të nxënësve dhe rezultateve positive të vlerësimit dhe ngritjes, - Punë ekipore me kolegët, me aktivitetet profesionale me prindër dhe komunitetin, <p>Demonstrim i qartë i besimit, shkathtësive dhe reflektimit.</p> <p>Në funksion të arritjes së këtyre kompetencave, programi ka këtë strukturë:</p> <p>Përveç 81 orëve trajnim të përshkruara më lartë, për këtë lloj të licencës, programi përmban edhe dy aktivitete/detyrave praktike plotësuese:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Hartimin e materialeve (broshurë, informator, material pune, etj) për përdorim brenda shkollës për ndërgjegjësimin e akterëve (mësimdhënësve, nxënësve, prindërve dhe komunitetit të shkollës) lidhur me gjithpërfshirjen në arsim= 10 orë angazhim shtesë, 2. Realizimin e një trajnimi/punëtorie me bazë në shkollë me mësimdhënës, nxënës dhe prindër lidhur me = 6 orë angazhim shtesë. <p>Gjithësejorë trajnimi për certifikim: 97 orë trajnimi të bartura në certifikim</p>
<p>Përfituesit:</p>	<p>Trajnimi është përgatitur për mësimdhënësit/et e të gjitha niveleve të arsimit parauniversitar. Ekipet e mësimdhënësve nga e njëjta shkollë pritet që të marrin pjesë dhe të bashkëpunojnë për realizimin e detyrave të marra pas çdo pjese të trajnimit. Pjesëmarrja e tyre duhet të jetë në pajtimin dhe me mbështetje nga drejtori i shkollës dhe këshilli i shkollës (Këshilli Drejtues i Shkollës).</p>
<p>Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:</p>	<p>22</p>
<p>Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:</p>	<p>Trajnimi synon zhvillimin e kapaciteteve të shkollave të Kosovës për të ofruar mjedis gjithpërfshirës dhe ndërkulturor që lehtëson dhe mbështet integrimin efektiv të fëmijëve romë, ashkali, egjiptianë dhe të kthyer (riatdhesuarve), duke rritur mundësitë e suksesit në shkollë të të gjithë fëmijëve.</p> <p>Objektivat kryesore të kurrikulës së trajnimit janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Rritja e ndërgjegjësimin të mësimdhënësve për rolin dhe përgjegjësitë e tyre në zhvillimin e nxënësve të tyre, si edhe për rëndësinë e adresimit të çështjeve si diskriminimi, racizmi, përfshirja sociale dhe të kuptuarit ndërkulturor, • Ofrimi i metodologjive dhe burimeve me një sfond teorik të qëndrueshëm duke u mbështetur në përvojën e Këshillit të Evropës në këtë fushë, të cilat mund të kenë përdorim praktik në aktivitetet që mund të organizohen në nivel shkollë, bazuar në një qasje që përfshirë gjithë shkollën, <p>Krijimi i mundësive për përfshirje aktive të mësimdhënësve në një reflektim kritik në lidhje me praktikën e tyre, në shkëmbimin e përvojave me kolegët dhe në gjenerimin e procesit të qëndrueshëm, demokratik dhe pjesëmarrës të zhvillimit të shkollës së tyre.</p>

<p>Përmbajtja:</p>	<p><u>Përmbajtja e trajnimit për PJESËNI</u></p> <ul style="list-style-type: none"> • Hapja, prezantimet, objektivat, rregullat, pritshmëritë, programi, • Pabarazia sociale, rrënjët e saj dhe pasojat tek fëmijët, • Roli i shkollave dhe mësimeve në riprodhimin e pabarazisë, • Racizmi: Diskriminimi direkt, indirekt dhe diskriminimi strukturor, • Qasja e gjithë shkollës për një shkollë gjithëpërfshirëse dhe ndërkulturore, • Krijimi i një klase gjithëpërfshirëse dhe ndërkulturore, • Shembuj të metodave, aktiviteteve dhe masave • nxëniet e bazuar në projekte, • Planifikimi i zhvillimit të shkollës. Puna ekipore, • Detyrat e shtëpisë: Detyrat deri në Pjesën e dytë të trajnimit. Vlerësimi, <p><u>Përmbajtja e trajnimit për PJESËNII</u></p> <ul style="list-style-type: none"> • Hapja e pjesës së dytë të trajnimit dhe rishikimi i Planeve të Zhvillimit të Shkollës, • Rishikimi i rasteve studimore për fëmijët e sapoardhur në klasë, • Nxitja e gjithëpërfshirjes së fëmijëve të riatdhesuar romë, ashkalinj dhe egjiptianë, • Ushtrime për të nxënësit bashkëpunues gjatë punës me fëmijët e kthyer, • Ndërgjegjësimi kulturor, ndërgjegjësimi gjuhësor dhe edukimi ndërkulturor, • Mentorimi dhe ndërmjetësimi nga bashkëmoshatarët (në mes të nxënësve) , • Bashkëpunimi me prindërit. Roli i ndërmjetësuesve arsimorë në shkollorë. • Bashkëpunimi me ndërmjetësuesit dhe qendrat mësimore • Mbyllja e pjesës 2: Detyrat e shtëpisë dhe vlerësimi <p><u>Përmbajtja e trajnimit për PJESËN III</u></p> <ul style="list-style-type: none"> • Hapja dhe shqyrtimi i planeve për zhvillim të shkollës dhe aktivitetet në klasë • Puna e përbashkët: "Shtëpia e ëndrrave të mia" • Adresimi i çështjeve të evidentuara nga analiza e aktiviteteve shkollore dhe vizitave nëpër shkolla: Planet mësimore • Partneriteti online si mjet për arsimim ndërkulturor dhe gjithëpërfshirje shoqërore • Vlerësimi i aktiviteteve arsimore • Si mundet që një vlerësim me pjesëmarrje participuese të mbështesë zhvillimin e shkollës, • Mbyllja e trajnimit.
<p>Metodat e realizimit të programit</p>	<p>Metodologjia e zbatuar gjatë trajnimit është një kombinim i :</p> <ul style="list-style-type: none"> - Ligjerimeve dhe prezantimeve; - Ushtrimeve interaktive, të cilat, në pjesën më të madhe mund të përsëriten ose të përshtaten për përdorim me nxënësit; - Punës grupore; - Punës individuale. <p>Në trajnim u ipet prioritet zbatimit të metodat interaktive dhe aktivitetet që stimulojnë reflektimin, bashkëpunimin dhe kreativitetin. Në seancat e fundit të trajnimit jepet hapësirë për t’ju përgjigjur nevojave shtesë specifike të pjesëmarrësve me qëllim të adresimit të temave të tjera të ndërlidhura ose thellimin e atyre temave që janë adresuar/trajtuar tashmë në seancat e mëparshme.</p>

Certifikimi	<i>Mësimdhënës i karrierës: 81 orë trajnim</i> <i>Mësimdhënës i avancuar: 97 orë trajnimi</i>
Trajner sa trajner	6
Data e aplikimi	

Titulli i programit 90	Programi 3 SITË AVANCOHET PËRHERË EFIKASITETI DHE EFEKTIVITETI I ARSIMIT PARAUNIVERSITAR?
Titulli i organizatës	Qendra për Avancim e Performancës së Arsimit-QAPA
Tipi i programit:	
Ofertuesi i programit:	
Adresa:	Lidhja e Pejës Zona Industriale 10000 Prishtinë
E-mail:	info@qapa-ks.org
Telefoni:	038/601/510
Numrat dhe data e akreditimit:	120/2015 Organizata pranohet për 5 vite 16.01.2015
Kohëzgjatja e programit(orë)	15 orë ose 3 ditë
Përfituesit:	Drejtorët ,mësimdhënësit, bashkëpunëtorët profesional dhe zyrtarët arsimor
Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:	
Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:	<p>Pas përfundimit të trajnimit pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:</p> <ul style="list-style-type: none"> v Demonstrjnë aftësi dhe shkathtësi për përshkrimin dhe shpjegimin e koncepteve :Efikasitet (kuantitet, efijencë);cilësi(efektivitet ,kualitet);zhvillim njerëzor :kapital njerëzor ,kapitali I dijeve ,menaxhimi total me cilësi-MTC, Shkollë e mire ,shkollë efektive/cilësore; shkollë mike për fëmijë v Bëjnë një përshkrim të shkurtë të zhvillimit të menaxhimit total me cilësinë /MTC/ v Argumentojnë se cilësia në edukim dhe arsim është mjet strategjik I krijimit të shtetit demokratik dhe ligjor me njeriun në qendër v Identifikojnë prioritetet themelore për avancimin e efikasitetit dhe të efektivitetit të arsimit parauniversitar v Përshkruajnë katër faktorët që garantojnë cilësi të West-Burnhamit v Përshkruajnë dhe vlerësojnë pjesët kryesore të garantimit të cilësisë v Përshkruajnë dhe demonstrjnë aftësitë në përdorimin e metodave teknikave dhe veprimeve për grumbullimin e informacione për efikasitetin dhe efektivitetin e sistemit të arsimit parauniversitar <p>Përshkruajnë kriteret e efikasitetit dhe të cilësisë së punës në institucionet e arsimit para universitar</p>

Përmbajtja:	<p>1. Konceptet themelore lidhur me efikasitet dhe efektivitetin e institucioneve arsimore</p> <p>2. Zhvillimi i Menaxhimit Total me Cilësinë-Efikasitetin dhe efektivitetin ,si instrument strategjik të zhvillimit të Kosovës (ç është institucioni - shkolla e mirë ,katër kërkesat për kujdesin :institucionin shkollën e mirë ;vlerësimi i jashtëm ;PISA; vetëvlerësimi ,metodat teknika dhe veprimet për grumbullimin e informacioneve për efikasitetin dhe efektivitetin e institucioneve të arsimit parauniversitar.</p> <p>3. Ndikimi i disa elementeve të sistemit dhe procesit në cilësinë e punës së shkollës</p> <p>4. Vlerësimi i arritjeve të kandidatëve me anë të testit të standardizuar informimi, argumentimi, certifikimi</p>
Metodat e realizimit të programit	
Certifikimi	PO
Datë	15.01.2015
Nr.i trajnerëve	4

Programi 4	
Titulli i programit 91	SITË KRIJOHET KULTURA POZITIVE DHE KLIMA ANTICIPATIVE NË INSTITUCIONET ARSIMORE?
Titulli i organizatës	Qendra për Avancim e Performancës së Arsimit-QAPA
Tipi i programit:	
Ofertuesi i programit:	
Adresa:	Lidhja e Pejës Zona Industriale 10000 Prishtinë
E-mail:	info@qapa-ks.org
Telefoni:	038/601/510
Numrat dhe data e akreditimit:	120/2015 Organizata pranohet për 5 vite 16.01.2015
Kohëzgjatja e programit (orë)	15 orë ose 3 ditë
Përfituesit:	Drejtorët ,mësimdhënësit, bashkëpunëtorët profesional dhe prindërit
Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:	
Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:	<p>Pas përfundimit të trajnimit pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:</p> <ul style="list-style-type: none"> v Përshkruajnë dhe të shpjegojnë konceptet themelore (klima shkollore, etosi shkollor, identiteti i shkollës ,kultura shkollore ,horizonti shkollor, shpirti horizontal ,mjedisi etik shkollor ,ekologjia shkollore ,ambienti shkollor, sfondi kulturor i shkollës, konteksti shkollor ,mjedise shkollor kurrikuli i fshehur etj. v Përkufizojnë kulturën shkollore v Identifikojnë faktorët kryesor të kulturës shkollore v Ndërtojnë piramidën e faktorëve të kulturës shkollore v Identifikojnë vlerat themelore të kulturës së shkollës v Ndërtojnë piramidat e vlerave dhe parimeve të gjithë vlefshme të kulturës shkollore v Të identifikojnë rolet dhe parimet e ndryshimeve të cultures shkollore v Të demonstrojnë aftësi në planifikime strategjike të ndryshimeve pozitive në kulturën shkollore
Përmbajtja e programit (jo më shumë se 200 fjalë)	<p>1. Konceptet themelore për klimën dhe kulturën shkollore (klima shkollore ,etosi shkollor, kultura shkollore, horizonti shkollor etj)</p> <p>Dallimet terminologjike ,ndëmet klimës dhe kulturës .Ndërlidhjet korrelative ndërmjet klimës dhe kulturës shkollore</p> <p>2. Faktorët që ndikojnë në klimën dhe kulturën shkollore. Identifikimi i faktorëve ,krijimi i piramidës të raporteve sipas hierarkisë. Vlerat themelore kulturore të institucioneve shkollore. Ndikimi në klimën dhe kulturën shkollore ,ndryshimet pozitive në klimën dhe kulturën shkollore, ndryshimet pozitive në klimën dhe kulturën e institucioneve shkollore</p>
Metodat e realizimit të programit	
Certifikimi	Po
Datë	15.01.2015
Nr.i trajnerëve	4

Titulli i Programit 92	Sistemi i monitorimit dhe evaluimit – Sigurimi i cilësisë në shkollë
Titulli i organizatës	LuxDev Project KSV/020 Smart Bits
Tipi i programit:	Program trajnues plotësues
Ofertuesi i programit:	LuxDev Project KSV/020 Smart Bits
Adresa:	Rr. Agim Ramadani p.n., 10000 Prishtinë Rr. Xheladin Hana p.n., 10000 Prishtinë
E-mail:	Daniele Cristian Passalacqua: daniele.passalacqua@luxdev.lu Bekim Kasumi: bekim.kasumi@smart-bits.ch
Telefoni:	Daniele Cristian Passalacqua: +38345300916 Bekim Kasumi: +38344168688
Numrat dhe data e akreditimit:	Nr.82./2018 Datë:12.11.2018 Programi aprovohet për një vit nga ana e MASHT-it
Kohëzgjatja e programit (orë)	16 orë
Përfituesit:	Sistemi i monitorimit dhe evaluimit është një platformë që iu dedikohet në rend të parë menaxhmentit të shkollave të mesme të larta dhe koordinatorëve të cilësisë.
Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:	16 kandidatë për sesion të trajnimit
Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:	Objektivat kryesorë të programit janë: <ul style="list-style-type: none"> · Aftësimin në përdorimin e platformës për digjitalizim të monitorimit dhe evaluimit të cilësisë, · Aftësimin në përdorimin e indikatorëve standard për monitorimin e cilësisë, · Gjenerimin e raporteve të monitorimit dhe evaluimit të cilësisë.
Përmbajtja:	Temat e shtjelluara në kuadër të këtij moduli janë: <ul style="list-style-type: none"> · Të kuptojrëndësinë e monitorimit dhe evaluimit të indikatorëve të cilësisë · Të dijtë 'i përdorë funksionet kyçe të platformës digjitale për monitorim dhe evaluim të cilësisë · Të krijoj pyetësor për të mbledhur informata për indikatorë të ndryshëm (p.sh. niveli i përmbushjes së pritshmërisë të bizneseve në raport me kurset e ofruara, apo niveli i përmbushjes së pritshmërisë të nxënësve apo mësimeve në raport me materialet mësimore, etj.) · Të gjenerojë raporte semestrale, gjysmë-vjetore, vjetore, apo sipas nevojës.
Metodat e realizimit të programit	Për të siguruar realizim të suksesshëm të objektivave të programit, masat në vijim do të aplikohen: <ul style="list-style-type: none"> · Objektivat e mësimi / trajnimit, · Mësimi i orientuar në shkathësi dhe kompetenca, · Njohjen paraprake të nevojave të pjesëmarrësve të trajnimit dhe ofrimin e trajnimit konform atyre nevojave, · Disponueshmëria e pjesëmarrësve, · Vendet e trajnimit, · Materialet e trajnimit, · Aftësitë e trajnerit.

Certifikimi :	Certifikatë modulare pas përfundimit me sukses të detyrave që ndërlidhen me modulet përkatëse
Trajner sa trajner	4 trajnerë të programit dhe trajnimi i 10 master trajnerëve
Data e aplikimi	26.10.2018

Titulli i Programit 93	Siguria në TI
Titulli i organizatës	ECDL Kosova
Tipi i programit:	Program trajnues themelor
Ofertuesi i programit:	ECDL Kosova
Adresa:	Rr. Xheladin Hana p.n., 10000 Prishtinë
E-mail:	sovran.berisha@ecdl-kosova.org
Telefoni:	+383 44 375 963
Numrat dhe data e akreditimit:	Nr.91/2018 Datë:12.11.2018 Programi aprovet për një vit nga ana e MASHT-it
Kohëzgjatja e programit(orë)	16 orë
Përfituesit:	Mësimdhënësit e të gjitha lëndëve mësimore Koordinatorët e cilësisë Punonjësit e administratës së shkollës Menaxhmenti (drejtori) e shkollës
Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:	16 kandidatë për grup të trajnimit
Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:	Të gjithë kandidatët të cilët e përfundojnë me sukses këtë program të trajnimit do të jenë në gjendje të: <ul style="list-style-type: none"> · Kuptojnë konceptet kyçe që lidhen me rëndësinë e informacionit të sigurt dhe të dhënave, · të sigurisë fizike, intimitetit dhe vjedhjet e identitetit. · Mbrojnë një kompjuter, pajisje ose rrjet nga malwer-et dhe qasjet e paautorizuara. · Kuptojnë llojet e rrjeteve, llojet e kyçjes dhe çështjet specifike të rrjetit duke përfshirë · firewalls. · Shfletojnë World Wide Web dhe të komunikoj sigurt në internet. · Kuptojnë çështjet e sigurisë që lidhen me komunikimin, duke përfshirë e-mail dhe SMS. · Bëjnë ruajtjen dhe rivendosjen e të dhënave në mënyrë të drejtë dhe të sigurt, si dhe fshirjen · /shkatërrimin e sigurt të të dhënave dhe të pajisjeve.
Përmbajtja:	Ky program përmban temat në vijim: <ul style="list-style-type: none"> · Të kuptuarit e vlerës së informacionit · Njihja me sigurinë e dokumentit · Funksionet e Malware · Siguria e wireless-it · Siguria personale · Njohja me rrjetet sociale.
Metodat e realizimit të programit	<ul style="list-style-type: none"> · Definimi i qartë i objektivave të mësimit / trajnimit, · Mësimi i orientuar në shkathtësi dhe punë praktike, · Njohjen paraprake të nevojave të pjesëmarrësve të trajnimit dhe ofrimin e trajnimit konform atyre nevojave, · Disponueshmëria e pjesëmarrësve, · Kabinetet ku mbahet trajnimi, · Materialet e trajnimit, · Aftësia e trajnerit.
Certifikimi	Certifikimi në këtë program bëhet pasi kandidati të ketë kaluar provimin me sukses prej së paku 75%.
Trajner sa trajner	3 trajnerë
Data e aplikimi	26/10/2018

Titulli i programit 94	Programi 5 SI TI ZVOGËLOHET ENTROPIA NË INSTITUCIONET SHKOLLORE?
Titulli i organizatës	Qendra për Avancim e Performancës së Arsimit-QAPA
Tipi i programit:	
Ofertuesi i programit:	
Adresa:	Lidhja e Pejës Zona Industriale 10000 Prishtinë
E-mail:	info@qapa-ks.org
Telefoni:	038/601/510
Numrat dhe data e akreditimit:	120/2015 Organizata pranohet për 5 vite 16.01.2015
Kohëzgjatja e programit(orë)	25 orë ose pesë ditë
Përfituesit:	Drejtorët , zyrtarë arsimit, bashkëpunëtorët profesional mësimdhënës dhe prindërit
Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:	
Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:	<p>Pas përfundimit të trajnimit pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:</p> <ul style="list-style-type: none"> v Përshkruajnë dhe shpjegojnë konceptet themelore të sistemit kibernetik, konceptet: organizmi, sistem, input, procesin, autput, teoria mbi organizmin shkencor , mjedisi i rregulluar, entropia, teoria e informacionit, teoria e analizës sistemore, teoria e reinovacionit ndërmjet ringjiniert, organizimi virtual, organizimi frontal, organizimi rrjetor v Përshkruajnë zhvillimin e Teorisë së Organizimit Shkencor të Punës-TOSHP dhe të teorive bashkëkohore të organizimit v Përshkruajnë kontekstin shoqëror politik në organizimin e institucioneve shkollore v Identifikojnë burimet financiare të organizimit shkollor v Përshkruajnë organizimin e shkollës dhe të lidhjes së saj me potencialet zhvillimore v Shpjegojnë llojet dhe filozofinë e kurrikulave v Të demonstrojnë shkathtësinë për planifikimin, sigurimin dhe menaxhimin e financave

Përmbajtja:	<p>1. Konceptet themelore për organizimin e punës së institucioneve shkollore: Shkolla sistem kompleks kiberentik. Zhvillimi i shkurtë historik i Teorisë së Organizimit Shkencorë. Teoritë bashkëkohore të organizimit të punës në mësimdhënie dhe në të nxënësve</p> <p>2. Konteskti shoqëror-historike dhe politik i organizimit të institucioneve shkollore</p> <p>3. Reforma e kurrikulit me theks të veçantë në kurrikulin shkollore: Koncepti i kurrikulit ,komponentët e kurrikulit ;reforma kurrikulare, kush i kontribuon reformës kurrikulare ,llojet e kurrikulit perspektiv globale e institucioneve arsimore-termat :autonomi shkollore, autonomia e nxënësve ,dijet, aftësitë vlerat globale, edukimi multikultural:</p> <p>4. Menaxhimi financiar dhe administrativ i burimeve financiare: burimet primare dhe sekondarë, shpenzimet financiare dhe organizimi financiar ,menaxhimi i financave</p> <p>5. Organizimi i shkollës dhe potencialet zhvillimore të saj. Përvoja dhe shembuj të organizatave të suksesshme</p>
Metodat e realizimit të programit	
Certifikimi	
Datë	15.01.2015
Nr.i trajnerëve	4
Titulli i organizatës	Qendra për Avancim e Performancës së Arsimit-QAPA

Titulli i Programit 95	Strategjitë e Nxënies Eksperienciale
Titulli i organizatës:	Organizata Kosovare për Talent dhe Arsim - TOKA
Tipi i programit:	Program themelor
Ofertuesi i programit:	Organizata Kosovare për Talent dhe Arsim - TOKA
Adresa:	Meto Bajraktari 4-1, 10000 Prishtinë
E-mail:	info@toka-ks.org
Telefoni:	+381 (0) 38 704 560 ose +377 (0) 45 825 520
Numrat dhe data e akreditimit:	Numër: 32/2018 Data: 31.07.2018 Programi aprovohet për një vit nga ana e MASHT-it
Kohëzgjatja e programit(orë)	48 orë trajnim dhe 30 orë mentorim
Përfituesit:	<ul style="list-style-type: none"> - Mësimdhënës të shkollave të mesme të ulëta - Mësimdhënës të shkollave të mesme të larta
Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:	Numri optimal i pjesëmarrësve për një trajnim është 30 persona
Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:	<ul style="list-style-type: none"> · Rritja e shkathtësive të mësimdhënësve në zhvillimin e metodave të edukimit joformal · Rritja e shkathtësive të mësimdhënësve në zhvillimin e aktiviteteve të edukimit joformal · Përgatitja teorike dhe praktike e mësimdhënësve në hapjen e klubeve të vullnetarëve në shkollat e tyre · Rritja e shkathtësive të mësimdhënësve në menaxhimin dhe udhëheqjen e një klubi të vullnetarëve prej së paku 25 vetash për një vitshkollor · Rritja e aftësive të mësimdhënësve në planifikimin dhe implementimin e së paku një projekti të vullnetarizmit në komunitetin ku jetojnë · Të nxitet zhvillimi i shkathtësive të reja tek të rinjtë e moshës 14-17 vjeç (p.sh. punë me dru) · Të nxitet zhvillimi i vlerave të reja tek të rinjtë 14-17 vjeç (p.sh. të qenit qytetar aktiv) · Të krijohet një mjedis për përfitimin e njohurive të reja tek të rinjtë e moshës 14-17 vjeç (p.sh. diskutimi se çfarë është komuniteti)

Përmbajtja:

Strategjitë e Nxënies Eksperienciale fokusohet në ngritjen e vullnetarizmit edukativ (Service Learning) tek të rinjtë e moshës 14-17 vjeç në Kosovë. Duke parë se në Kosovë, të rinjtë kanë një interes të shtuar në programe të cilat i lejojnë ata të bëjnë përvojë pune dhe të formojnë rrjete të mundësive në shkollë dhe karrierën profesionale, ky program do t'u mundësoj atyre të përfitojnë shkathtësi, vlera dhe njohuri të reja të cilat do t'u shërbejnë në të ardhmen.

Ky program **përfitues primar** ka mësimitdhënësit e shkollave të mesme të ulëta dhe të larta të Kosovës. **Përfitues sekondar** janë të rinjtë e shkollave të mesme të ulëta dhe të larta të Kosovës. **Përfitues terciar** janë komunitetit që gjinden pranë shkollave në të cilat janë hapur klubet e vullnetarëve.

Programi ndahet në tri faza:

Faza 1- Trajnimi i mësimitdhënësve mbi vullnetarizmin edukativ dhe metodat e edukimit joformal.

Trajnimi fokusohet në përfitimin e shkathtësive të reja të metodologjisë së punës së edukimit joformal dhe përgatitjen e mësimitdhënësve për hapjen dhe udhëheqjen e klubeve të vullnetarëve në shkollat ku punojnë. Kështu, trajnimi ka një kohëzgjatje prej 6 ditësh duke u mundësuar mësimitdhënësve përgatitjen dhe gatishmërinë sa më të madhe në implementimit të programit pas përfundimit të trajnimit.

Përmbajtja e trajnimit fokusohet në:

